



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 13.7 dhe 14.7, lidhur me nenin 16.2 dhe nenin 19.2 e 33 të Ligjit për planifikim hapësinor nr. 2003/14, të dt. 3.7.2003, të shpallur sipas Rregullores nr. 2003/30, të dt.10.9.2003; të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr.2000/45, të dt. 11 gusht 2000, të nenit 19, par.1, pika b dhe të nenit 40, par.3, pika II të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 17.05.2007, merr

V E N D I M

PËR SHQYRTIM PUBLIK TË PROPOZIMPLANIT RREGULLUES PËR LAGJEN “SOFALIA” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues për lagjen “Sofalia” në Prishtinë. Propozimplanit, nga paragrafi 1 i këtij neni, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat paraqesin pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

Neni 2

Shqyrtimi publik i Propozimplanit rregullues, sipas këtij Vendimi, zgjat 30 ditë, duke llogaritur nga dita e parë vijuese pas miratimit të tij në Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

Organizimin e shqyrtimit publik të Propozimplanit, sipas këtij Vendimi, do ta bëjë Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimitarisë i Komunës së Prishtinës.

Neni 3

Pas përfundimit të shqyrtimit publik të Propozimplanit, nga neni 1 i këtij Vendimi, Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimitarisë, do të kryejë veprimet e parapara ligjore për finalizimin e këtij plani, në mënyrë që ai t`i prezantohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve të Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. Nr.35-2001, dt.17.05.2007

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri